



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 qershor 2012
Nr.Ref.:RK256/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI 08/12

Parashtrues

Nexhat Shala

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë
Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Pareshtruesi i Kërkesës

1. Kërkesa u parashtua nga Nexhat Shala (parashtruesi) me vendbanim në Barilevë, komuna e Prishtinës, i përfaqësuar nga Hasan Rexha, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011, të cilin e ka pranuar me 7 korrik 2011 dhe me të cilin u vendos t'i refuzohej kërkesa e tij për përsëritje të procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave në pronë, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe patundshmërinë kontestuese (banesën).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 9 nëntor 2011.
6. Më 11 nëntor 2011, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi informata shtesë për shterimin e mjeteve juridike.
7. Më 13 janar 2012, Gjykata sërish kërkoi nga parashtruesi ta kompletonte kërkesën dhe ta dorëzonte vendimin përfundimtar për çështjen e tij.
8. Më 30 janar 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e kompletuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.
9. Më 1 mars 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR 08/12, caktoi gjyqtarin Almiro Rodriguez Gjyqtar raportues dhe me Vendimin nr. KSH 08/12 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).
10. Më 20 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Në qershor të vitit 2005, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë me Ali Gashin për blerjen e banesës 85.13 m², që gjendet në rrugën "Gjergj Fishta" në Lipjan. Kontrata e shitblerjes është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan më 9 shtator 2005. Më 14 qershor 2005, Ali Gashi (shitësi) ia shiti Rasim Shabanit (blerësi) të

njëjtën patundshmëri. Pasi objekti i shqyrtimit në këto dy kontrata kishte të bënte me patundshmërinë e njëjtë, kjo rezultoi në kontest ligjor. Si rrjedhojë, u zhvilluan procedura të ndryshme civile dhe penale në mënyrë që palët e interesuara t'i siguronin të drejtat e tyre.

12. Në të vërtetë, më 6 shtator 2006, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktgjykimi C. nr. 248/06) ia njohu Rasim Shabanit të drejtën e pronësisë së banesës. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Më 12 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, (Aktgjykimi Ac. nr. 971/2006) e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan.
13. Më 13 shkurt 2007, parashtruesi ushtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Lipjan për përsëritje të procedurës për lëndën C. nr. 248/2006, të 6 gushtit 2006, duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarit që kishte vendosur në shkallë të parë. Më 28 tetor 2010, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktvendimi C. nr. 216/2010) e hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesit sepse Aktgjykimi C. nr. 248/2006, i 6 gushtit 2006, u bë i plotfuqishëm dhe nuk ishte i bazuar në dëshmi të rreme. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
14. Më 28 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 1107/2010) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar për shkak se aktvendimi i ankimuar (C. nr. 216/2010) nuk përmbante shkelje thelbësore që do të ndikonin në ligjshmërinë e vendimit të ankimuar.
15. Më 26 gusht 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit në Prishtinë kundër Aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 216/2010. Më 9 shtator 2011, Prokuroria e Shtetit e njoftoi parashtruesin se kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë ishte refuzuar për shkak se nuk ishte gjetur asnjë bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mjete juridike.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke ia hedhur poshtë kërkesën për përsëritje të procedurës, ia ka shkelur të drejtat e tij të përcaktuara në dispozitat Kushtetuese në vijim: Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 54 [E Drejta për Mbrojtje Gjyqësore], si dhe Nenin 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 216/2010, të 28 tetorit 2010, dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2010.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

19. Së pari, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Gjykata konsideron që parashtruesi e ka arsyetuar kërkesën me një përmendje të qartë të shkeljeve të supozuara; ai posaçërisht konteston vendimin e Gjykatës së Qarkut si aktin konkret të organit publik që është objekt i shqyrtimit; qartazi tregon se çfarë dëshiron të arrijë; dhe bashkëngjit vendime të ndryshme dhe informata e dokumente të tjera mbështetëse.
20. Megjithatë, me rastrin e shqyrtimit të mbështetjes me prova të kriterit të kërkesës, Gjykata vëren që neni 48 përcakton që *“parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar”*.
21. Në anën tjetër, rregulli 36 i Rregullores së punës përcakton që *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
22. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që *“Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën (...) nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore”*.
23. Gjykata vëren që vlerësimi i ligjshmërisë së kontratave është kompetencë e gjykatave të rregullta. Rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të ndërhyjë.
24. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk tregon pse dhe si Gjykata e Qarkut ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane as nuk ofron prova për shkeljen e supozuar.
25. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë në këtë rast. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

27. Në të vërtetë, parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Qarkut ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata e Qarkut. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
28. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen që kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, është qartazi e pabazuar dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe procedohet.
29. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, rregullin 36.2 (b) dhe (d), rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Almiro Rodriguez



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani